



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.16

Prishtinë, më 14.5.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Albert Kinolli, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Mufera Serbica Shinik dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), ZijushAhmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe CelalIliaz, drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq -kryetar i Komisionit .

Për këtë mbledhje u propozua:

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Inicimi i Komisionit për nismën legislative të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Kryetari, konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.*

## **2. Inicimi i Komisionit për nismën legislative të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;**

**Kryetari**, tha se në mbledhjen e fundit, anëtarët e komisioni u dakordua që të fillohet procedura e nismës legislative për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, të propozuar nga Veton Berisha, me qëllim që të shtohet ‘24 Qershori’, ditë e Egjiptianëve, dhe propozimi i dhënë nga GP të Listës Serbe, të shtohet, data 15 shkurt dhe 28 qershorë, ditë memoriale për komunitetin serbë.

**Veton Berisha**, veqoi se propozimi i nismës legislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, ka për qëllim të plotësohet neni 5.5 i Ligjit, në Ditët Memoriale të shtohet ‘24 Qershori’, ditë e Egjiptianëve.

Sa i përket amandamentimit të këtij projektligji, nuk trajtohet çështja lidhur me shtimin e një ditë pushimi, kryesisht atë ditë përkujtohen vlerat, mbahen aktivitete të ndryshme, pra bëhet promovimi i të drejtave të komunitetit të caktuar. Ky kriter garantohet me Kushtetutë, që është bazë standarde për rregullimin e të drejtave të komuniteteve.

Theksoi se janë kryer të gjitha aktivitetet e planifikuara, dhe shtoi se është marr deklarë për pajtueshmëri me legjislativën e BE-së, vlerësimi i ndikimit buxhetor, në të njëjtën kohë është marr memorandum i shpjegues i këtij projektligji i cili ka të bëjë me qëllimin e ligjit. Pasi jemi në fund të muajit maj dhe është afër data 24 qershor, ai kërkoi që kërkesa e tij të procedohet në afat sa më të shkurt.

Në fund, ai kërkoi të marr pëlqimin dhe mbështetjen e komisionit dhe i njëjti të procedohet për shqyrtim në Kryesi dhe të miratohet në Kuvend.

**Danush Ademi**, është i pajimit me propozimin e Vetonit që të vazhdohet me procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare.

Njëkohësisht, dha propozim konkret që me vendim të veçantë të caktohet ditë pushimi për komunitetet joshumicë. Këtë propozim e arsyetoi duke thënë se festat zyrtare për komunitetet duhet të rregullohet me Ligj, siq janë të rregulluara ditët kombëtare për qytetarët e Kosovës.

**Albert Kinolli**, ai në plotëni e përkrahë propozimin që të vazhdohet nisma legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare, me qëllim që të shtohet ‘24 Qershor’, ditë festive për komunitetin egjiptian. Konsideron, se ditët memoriale janë rregulluar me këtë Ligj, andaj mirë është që edhe komuniteti egjiptian të gëzojë të drejtat e njëjta si çdo komunitet tjetër i cili jeton në Kosovë.

**Kujtim Shala**, dha një sqarim plotësues, ditët memoriale nuk përcaktohen me ditë pushimi siq janë ditët e festave zyrtare të rregulluara me këtë Ligj, por kanë të drejtë të festojnë dhe përkujtojnë festat e tyre edhe komuniteti i caktuar. Në diskutimin e tij tha se me këtë ligj nuk janë përfshirë shumë ditë festive edhe të komunitetit shqiptar, përbërja e të cilit pasqyron diversitetin e shoqërisë kosovare. Për këtë arsye vota ime do të jetë e përmbytur.

**Kryetari**, theksoi se ka vërejtje në nenin 2 pragrafi 2.1 pika j, dhe propozoi të bëhet harmonizimi i tekstit, versioni në gjuhën serbe me tekstin në gjuhën Shqipe dhe Angleze, si në vijim: 7 Janar – Krishtlindjet ortodokse.

Si propozimim i dytë, kërkoi të ndryshohet dhe plotësohet neni 5,5 me tekstin si në vijim; të shtohet data ‘15 qershor dhe 28 korrikut’, ditë memoriale për komunitetin serbë.

Ky formulim nuk qëndron në ligjin bazik, prandaj kërkoi që i njejtë të miratohet në komision dhe të inkorporohet në raport final.

Ai foli në emër të GP të Listës Serbe se do të përkrahim propozimin e Vetonit, që në ditët memoriale të shtohet 24 qershorë, ditë e egjiptianëve.

**Veton Berisha**, personalisht nuk pajtohet me diskutimin e kolegut Danush, i cili propozoi që me rastin e festave të caktohet një ditë pushimi, nga se nuk është në interes të komuniteteve, pasi edhe ashtu kemi ngecë mbrapa në shumë procese.

Për informim, ky Ligj hynë në grupin e ligjeve me interes vital dhe për miratimin e tij kërkohen dy të tretat e votave, andaj kërkoi që të jenë prezent deputetët e listës serbe në kohën kur bëhet shqyrtimi i tij në Seancë Plenare

*Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim , nxori këtë:*

### **Përfundim**

- I. *Në mënyrë unanime Komisioni miratoi nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me propozimin e Veton Berishës, që në 'Ditët Memoriale' të shtohet data '24 Qershor', ditë e egjiptianëve.*
  - II. *Komisioni me shumicë të votave 8 Për, 1 Kundër dhe 2 Abstenim, miratoi propozimin e GP të Listës Serbe, të plotësohet neni 5,5, të shtohet data 15 shkurt dhe 28 qershor, ditë memoriale për komunitetin serbë.*
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

**Kryetari**, pasi nuk kishte propozime shtesë, ai hodhi në votim Projektligjin me amendamente të Komisionit Funksional, dhe konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtin me 7 (shtatë) vota Për, dhe 4 ( katër) Kundër, dhe nxori këtë:

### **Përfundim**

- I. Komisioni vlerësoi se Projektligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet miratimi i tij në shqyrtim të dytë.
- II. Përfaqësuesit e GP Lista serbe të përfaqësuar në strukturën e komisionit votuan kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojn të drejtat dhe interesat e komunitetit serbë.

### 3. Të ndryshme

**Veton Berisha**, në mbledhjen e kaluar, kam dalë me propozim që të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim të raportojë lidhur me implementimin e projektit në vlerë prej 1.800.000 € projekt ky i dedikuar për ndërtimin e shtëpive për banim për komunitetin joshumicë dhe joserbe. Gjegjlsisht, të ofrojë informata lidhur me ndarjen e vijës buxhetore, shumë e cila duhet të ndahet edhe për komunitetin egjiptian.

**Kryetari**, fillimisht i informoi anëtarët e Komisionit se ka pas kontakt me ministrin Dalibor Jevtiq, i cili më ka njoftu se do i përgjigjet ftesës së komisionit në çfarë do kohe, dhe i cili është i gatshëm të raportojë për temat të cilat ndërlidhen për interesin e komuniteteve dhe për çështjet tjera aktuale.

Ai veqoi se në takimin paraprak të Komisionit është propozuar që në takimin e përbashkët të ftohet Ministri i Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministri i Komuniteteve dhe Kthim dhe ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim me qëllim që të ofrojnë opinionet e tyre lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë. Lidhur me këtë qëndrim, unanimisht u pajtuan anëtarët e Komisionit.

*Kryetari, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë:*

#### **Përfundim**

*Komisioni me shumicë votave miratoi propozimin që të ftohen në takim të përbashkët ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim, me qëllim të raportimit lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për banim për komunitetin joshumicë.*

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00.*

*Përgaditur nga stafi mbështetës i Komisionit*

**Kryetar i komisionit,**

---

**Igor Simiq**